



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



Duke u mbështetur në nenin 40 nënparagrafi 40.2 nënparagrafi nën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr.03/040, nenit 40 paragrafi 2 nënparagrafi i fundit të Statutit të Komunës, në dispozitat e Udhëzimit Administrativ, nr.27/2012 MPB dhe 03/2012 MAPL- për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, me paraqitjen e Listës së propozimeve nga Zyra e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancë të I-rë, të radhës për vitin 2018, të mbajtur më datën 31.01.2018, mori këtë:

V E N D I M

Për

Themelimin e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi

I

Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi Themelohet nga Kryetari i Komunës, me Listën e propozimeve nga komunitetet përkatëse për anëtar të KKS, me emra dhe mbiemra si në vijim:

1. Kryetari i Komunës – Zenun Elezaj, Kryesues
Nënkryetari i Komunës -**Besim Hoti**- në mungesë të Kryetarit
2. Komandanti i Stacionit të Policisë në Komunë- **Rexhë Berisha**
3. Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare të komunës
- **Bashk. Islame-Fitim Bojaj**
- **Famullitari i Kishës Katolike-Don Lorenc Sopi**
- **Kisha Ortodokse- Stevan Markoviq**
4. Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të Komunës:
- **Marko Nedelković -serb**
- **Mire Rama - ashkali**
- **Azem Kerella - egjiptas**
- **Ramadan Gashi -rom**
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete.....
6. Zyrtari për Barazi Gjinore- **Remzije Maloku**
7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim- **Arben Limanaj**
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës- **Tunë Dedaj**
9. Një përfaqësues i FSK-së **Demë Maloku**
10. Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike:
-
-
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi-**Hava Thaqi**
12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale – **Elmi Zenuni**

13. Përfaqësues i Zyrës komunale për komunitete- **Silvija Rashković**
14. Një përfaqësues nga OJQ "Koha"- **Florida Gashi**
15. Komuniteti i Biznesit- **Prend Zefi**
16. KFOR-**Marko Maljevac**
17. Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara- **Halim Morina –OPAK-KOS**
18. **Shqipnora Dauti**-përfaqësuese e Kuvendit të Komunës
19. Mediat, **Radio "Alba"**Klinë.

II

Vendet vakante si në pikën 1të këtij vendimi plotësohen me propozimet e paraqitura nga komuniteti përkatës, në Zyrën e Kryetarit.

Anëtarët e KKSBB-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës.

III

Anëtarët e KKSBB kompensohen për 6 takime brenda vitit kalendarik nga buxheti i Komunës së Klinës dhe at ekuivalent me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Plani vjetor i Punës së KKSBB prezantohet në Kuvend për miratim.

IV

KKSBB mban së paku 6 takime brenda vitit, ndërsa tri prej tyre mbahen në gjashtëmuorin e I-rë të vitit kalendarik dhe i raporton Kuvendit për aktivitetet e tij dy herë në vit.

V

Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe 15 ditë pas dërgimit në Autoritetin Mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-633 2018
Klinë, më 06/02 2018



Kryesuesi,
Fadil Gashi